

**BASHKËPUNIMET E BASHKISË KAMËZ ME ORGANIZATAT PARTNERE NË
KUADËR TË PROJEKTEVE, AKTIVITETEVE DHE TRAJNIMEVE TË
ZHVILLUARA PËR KOMUNITETIN.**

QENDRA "DITË E RE" (GLOBAL CARE)

 **Email:** contact@globalcarealbania.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë lokale jo-fitimprurëse që punon për mbrojtjen dhe përmirësimin e jetës së fëmijëve në rrezik në Bathore, duke trajtuar sfidat e përditshme dhe duke ndërgjegjësuar komunitetin dhe politikëbërësit mbi mirëqenien e tyre.

QENDRA "ROSS CENTER"

 **Email:** hazisdoci@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë lokale jo-fitimprurëse në Shqipëri që fokusohet tek fëmijët me aftësi të veçanta intelektuale, përfshirë ata në spektrin e autizmit, duke ofruar terapi klinike, mbështetje psiko-sociale dhe aktivitete sensibilizuese për familjet dhe komunitetin.

WORLD VISION

 **Email:** worldvisionalbania@wvi.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë ndërkombëtare humanitare e krishterë që punon për fuqizimin afatgjatë të fëmijëve, të rinjve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë, duke u fokusuar në mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të fëmijëve, aktivizmin rinor dhe zhvillimin e aftësive për jetën, si dhe mbështetjen ekonomike për familjet.

NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR, ARSIS

 **Email:** initiative.arsis@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë që punon për mbrojtjen, fuqizimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve, grave, të rinjve dhe grupeve vulnerabël në Shqipëri. Përmes programeve të saj, ajo ofron mbështetje për fëmijët në nevojë, ndihmon në parandalimin e dhunës dhe trafikimit, siguron strehim emergjent, arsim dhe mundësi punësimi.

LIBURNETIK

 **Email:** info@liburnetik.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizata kontribuon në zhvillimin dhe sensibilizimin e shoqërisë në dobi të të rinjve dhe të target grupeve të marginalizuara, nëpërmjet një strategjie gjithëpërfshirëse, përmes realizimit të projekteve të ndryshme sociale.

MILIEUKONTAKT ALBANIA

 **Email:** milieukontakt.al@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizata fokusohet në mbështetjen e OJF-ve mjedisore, angazhimin e qytetarëve dhe komuniteteve, dhe promovimin e zgjidhjeve konkrete për problemet mjedisore për të siguruar një zhvillim ekologjikisht të qëndrueshëm.

QENDRA KOMBËTARE PËR SHËRBIME KOMUNITARE (NCCS)

 **Email:** nccs.albania@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizata punon për të integruar grupet më të pafavorizuara duke përfshirë komunitetet rurale, gratë, komunitetin rom, njerëzit që jetojnë në përjashtim social, si PLWHIV, përdoruesit injektues të drogës dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe njerëzve për të mbrojtur dhe avokuar për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe përfshirjen sociale.

ART IM PULSE

 **Email:** gertaqurku@yahoo.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë rinore që ka në qendër të punës së saj fuqizimin e të rinjve përmes artit, edukimit mediatic dhe pjesëmarrjes aktive qytetare, duke përdorur mjete krijuese si dokumentarët, poezinë, intervistat dhe videot me tematikë sociale për të zhvilluar aftësitë krijuese, komunikimin dhe mendimin kritik te të rinjtë.

NORTH GREEN ASSOCIATION

 **Email:** info@northgreen.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë që punon për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e mjedisit natyror në Shqipëri, duke promovuar praktika ekologjike, teknologji inovative, ruajtjen e energjisë dhe burimeve natyrore, ndërgjegjësimin dhe edukimin mjedisor të qytetarëve dhe fëmijëve, ndalimin e humbjes së biodiversitetit, vullnetarizmin dhe ruajtjen e pasurisë natyrore për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

INSITUTI LIBERAL PASHKO

 **Email:** info@ilp-al.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizata synon të kontribuojë në përparimin dhe demokratizimin e shoqërisë shqiptare përmes projekteve kërkimore të orientuara drejt politikave, ndërtimit të kapaciteteve dhe programeve të përbashkëta në fushat e promovimit të vlerave të lirisë, zhvillimit të qëndrueshëm të kulturës, trashëgimisë dhe turizmit, kërkimit dhe inovacionit, integritetit në Bashkimin Europian, respektimit të të drejtave të njeriut dhe përfshirjes sociale, si dhe inovacionit social dhe sipërmarrjes.

QATAR CHARITY

 **Email:** qcalbania@qcharity.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizata Bamirëse e Katarit mbështet komunitetet vulnerabël përmes një qasjeje të integruar humanitare dhe zhvillimore, duke ofruar ndihmë sociale dhe shërbime bazë në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe strehimit, duke fuqizuar ekonomikisht komunitetet, duke rritur kapacitetet lokale për reagim ndaj krizave, duke avokuar për të pambrojturit dhe duke promovuar kohezionin social, paqen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

FONDACIONI SË BASHKU

 **Email:** info@sebashku.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Fondacioni “Së Bashku” punon për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve me aftësi të kufizuara, duke forcuar kapacitetet e organizatave lokale të tyre, duke nxitur angazhimin e pushtetit lokal dhe atij qendror për zbatimin e të drejtave, duke shfrytëzuar mediat për rritjen e ndërgjegjësimit dhe duke punuar për përmirësimin e qasjes së shoqërisë shqiptare ndaj personave me aftësi të kufizuara.

ALERT

 **Email:** info@alert.al

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë me në fokus mbrojtjen e konsumatorit, edukimin dhe ndërgjegjësimin e tij dhe fuqizimi i publikut që të ngrejë zërin për të drejtat e tij.

UNITED RIGHTS FOUNDATION

 **Email:** unitedrightsfoundation23@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Fondacioni URF ka si mision të ndërtojë, promovojë, përmirësojë dhe mbrojë zhvillimin e shoqërisë shqiptare nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të projekteve që do të ndërmerren me synim; ndërtimin dhe promovimin e vlerave për një shoqëri të lirë, të drejtë dhe të barabartë si dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël nëpërmjet garantimit të të drejtave të njeriut.

ALBAACCESS OPEN

 **Email:** info@albaccess-open.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë që ka në fokus konsolidimin dhe avancimin e demokracisë për përparimin e shoqërisë civile, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në shtete ku ka kombësi shqiptare kudo ndodhen, ndërmjet bashkëpunimit efektiv me kapacitete institucionale qendrore, vendore, akademisë, komuniteteve.

TË NDRYSHËM DHE TË BARABARTË

 **Email:** contact@differentandequal.org

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë jo-fitimprurëse me fokus për të dhënë shërbime cilësore për ri/integrimin e viktimave të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të abuzimit dhe për të

përmirësuar kontekstin ligjor, institucional dhe social për të parandaluar dhe luftuar këto shkelje të të drejtave të njeriut.

SHKEJ

 **Email:** shkej@albmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë jo-fitimprurëse që punon për të fuqizuar individët dhe grupet e cënueshme, duke promovuar të drejtat dhe integrimin social, ofron shërbime të ndryshme, zhvillon kapacitete përmes aktiviteteve edukative dhe angazhohet në advokim për të përmirësuar jetën e individëve dhe komuniteteve.

QENDRA E TË DREJTAVE TË NJERIT NË DEMOKRACI

 **Email:** info@hrdc.al

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë që punon për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me fokus të veçantë grupet më vulnerabël të shoqërisë; siç janë grate/vajzat, të miturit, minoritetet etj.

TERRE DES HOMMES

 **Email:** alb.office@tdh.ch

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë që ka në fokus të sigurojë mbrojtje efektive dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve përmes forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, parandalimit të trafikimit dhe migracionit të pasigurt, dhe promovimit të drejtësisë restaurative për të miturit në konflikt me ligjin.

TLAS

 **Email:** tlas@tlas.org.al

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Shoqata e Ndihmës Ligjore të Tiranës (TLAS) përmbush nevojat sociale dhe ligjore të njerëzve në nevojë: edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare mbi sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut; promovimi i përmirësimeve në legjislacionin shqiptar; përparimi i komunitetit dhe forcimi i demokracisë

LINJA E KËSHILLIMIT PËR GRA DHE VAJZA

 **Email:** linjaekeshillimit@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizata punon për të avancuar barazinë gjinore, për të promovuar të drejtat e njeriut dhe për të garantuar akses në drejtësi dhe mbrojtje për gratë, vajzat dhe grupet e marginalizuara në të gjithë vendin.

LINJA E KËSHILLIMIT PËR BURRA DHE DJEM

 **Email:** info@clmb.al

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizantë jo-fitimprurëse e fokusuar në punën drejt barazisë gjinore nga këndvështrimi i meshkujve, si dhe synon reduktimin e dhunës në familje.

CRCA

 **Email:** crca@crca.al

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Organizatë joqeveritare, e cila punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, për t'i mbrojtur ata nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në nivelin kombëtar dhe lokal.

SHOQATA E DIABETIT NË SHQIPËRI

 **Email:** shoqata.diabeti@gmail.com

 **Përshkrim i veprimtarisë:** Shoqata e Diabetit në Shqipëri ka si qëllim kryesor informimin, këshillimin dhe edukimin e personave me diabet dhe familjarëve të tyre, duke ofruar materiale edukative mbi shenjat klinike, dietën, mjekimin dhe ndjekjen e diabetit.